# RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT "ALBSIG"

## PRILL 2026

**Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension("Fondi")

**Shoqëria Administruese**: Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.

**Monedha Bazë:** Lekë

**Politika e Investimit:** Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

## PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

**RREZIK I ULËT** — *Përfitime zakonisht të ulëta*

**RREZIK I LARTË** — *Përfitime zakonisht të larta*

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
|---|---|---|---|---|---|---|

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

**Të dhënat kryesore për Fondin më 30.04.2026**

| | |
|---|---|
| **Vlera Neto e Aktiveve:** | 990.607.362,35 ALL |
| **Çmimi për kuotë:** | 1.218,9201 ALL |
| ***Kthimi nga Investimit (30 Prill 2025 - 30 Prill 2026):** | 4.10% |

**Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*

## KOSTOT DHE TARIFAT

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

## SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

| Kategoria e Aktiveve | Vlera (në lekë) | % ndaj Aktiveve |
|---|---|---|
| Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. | 965,687,057.64 | **97,48** |
| Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë. | 24,920,304.70 | **2,52** |

## ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.




Kthimi vjetorë neto rezulton 4.10% për periudhën 30 Prill 2025 - 30 Prill 2026.
Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 30 Prill 2026. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **07.02.2020.**

| Albsig | 5Y | 3Y | 2Y | 1Y |
|---|---|---|---|---|
| **Norma Vjetore e Kthimit** | 3.57% | 4.11% | 4.16% | 4.10% |